

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MELIOR MED LABORATORIES” SH.P.K.

Sot, më date **09.07.2023**, ne të nënshkruarit:

- **Eralda Braka** lindur me 26/08/1989, shtetase shqiptare , lindur në Fier dhe banuese në Tiranë , mbajtëse e letërnjoftimit me nr.**037493001** , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Adela Serjani** lindur me 20/10/1994, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.**037560117**, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Petros Karampatsis** lindur me 02/01/1956, shtetas Grek , lindur në Oinousses dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.**AP3805962**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Alba Zaloshnja** lindur me 24/03/1990, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.**035814417**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Negisa Marku** lindur me 22/02/1989, shtetase shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë , mbajtëse e letërnjoftimit me nr.**037326039**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojmë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**MELIOR MED LABORATORIES**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**MELIOR MED LABORATORIES**” SH.P.K.

Neni 2


(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë , rruga “Myslym Shyri” , apartamenti me hyrje Nr.2 me zk.8250 dhe numer pasurie 905/7.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
meliormedlaboratories@gmail.com

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

Shërbime mjekësore laboratorike duke përfshirë, dhe jo vetëm, fushën e Biokimisë Klinike, Hemopatologjisë, Hemostazës, Imunologjisë/Serologjisë, Toksikologjisë, Mikrobiologjisë, Biologjisë Riprodhuese, Biologjisë Molekulare, Gjenetikës, Gjenomikës dhe testim të të gjithë mostrave biologjike. Konsulencë mjekësore, kontraktim për ofrim shërbimi për subjekte private dhe shtetërore lidhur me veprimtaritë e tyre, të lejuara me ligj. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër mbështetëse, që lidhet me aktivitetet kryesore të sipërpërmendura, etj.

-Megjithatë shoqëria ka të drejtë që të shtojë dhe të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5

Kapitali themeltar

1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njëqind mijë) Lekë
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Znj. Eralda Braka**: Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** (njëzet mijë) Lekë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Znj. Adela Serjani** : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** (njëzet mijë) Lekë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë..
3. Ortaku themelues **Z. Petros Karampatsis** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** (njëzet mijë) Lekë që përbën **20 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Ortaku themelues **Znj. Alba Zaloshnja** : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** (njëzet mijë) Lekë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë..
5. Ortaku themelues **Znj. Negisa Marku** : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **20 000** (njëzet mijë) Lekë që përbën **20%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.


Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakësimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta respektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblesë.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjërisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjërisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

1. Administratore e shoqërisë emërohet Znj. **Alba Zaloshnja** lindur me 24/03/1990, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. **035814417**, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e zgjedhur për një periudhë **3** vjeçare me të drejtë rizgjedhje.


2. Administratore e shoqërisë emërohet Znj. **Adela Serjani** lindur me 20/10/1994, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. **037560117**, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e zgjedhur për një periudhë **3** vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e t'jua dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Eralda Braka

Eralda Braka



Adela Serjani

Adela Serjani



Petros Karampatsis

Petros Karampatsis



Alba Zaloshnja

Alba Zaloshnja



Negisa Marku

Negisa Marku

